

LIGJ
Nr. 87/2024

**PËR RREGULLIMIN E PRODHIMIT, TREGTIMIT, KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT
TË ARMËVE, MUNICIONEVE, PAJISJEVE DHE TEKNOLOGJIVE USHTARAKE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

- përcaktimin e rregullave kryesore të funksionimit e të zhvillimit të industrisë së prodhimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake, demilitarizimit, tregtimit të tyre, si dhe kërkimit e zhvillimit në këtë industri;
- përcaktimin e parimeve, rregullave kryesore, si dhe institucioneve përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarive të ushtruara, sipas shkronjës “a” të këtij neni, nga subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në Republikën e Shqipërisë në këtë fushë;
- fuqizimin dhe rritjen e kapaciteteve ushtarake nëpërmjet sigurimit të armëve, teknologjive dhe pajisjeve ushtarake për Forcat e Armatosura ose strukturat e tjera të sigurisë që i përdorin ato.

Neni 2

Objekti i ligjit

1. Ky ligj përcakton rregullat për:

- krijimin dhe funksionimin e Agjencisë së Industrisë të Mbrojtjes;
- regjistrimin dhe licencimin e subjekteve, të cilat kryejnë veprimtari të rregulluara nga ky ligj;
- zhvillimin e veprimtarive të prodhimit, magazinimit, transportimit, tregtimit e të kërkimit dhe të zhvillimit teknologjik të armatimit ushtarak;
- masat minimalisht të detyrueshme për të garantuar pacenueshmërinë e shëndetit e të jetës së njerëzve, si dhe mbrojtjen e mjedisit e të botës së gjallë gjatë zhvillimit të veprimtarive të rregulluara nga ky ligj;
- bashkëpunimin me autoritete dhe subjekte kombëtare e ndërkombëtare në fushat e zbatimit të këtij ligji.

2. Ky ligj përcakton lehtësirat për subjektet që do të kryejnë veprimtari në industrinë ushtarake, si dhe kushtet e procedurat për dhënien e tyre.

Neni 3

Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

- “Armatim ushtarak” janë mallrat e përcaktuara në listën e mallrave ushtarake, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, sipas legjislacionit në fuqi për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake.
- “Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes” është autoriteti përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e sektorit të prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armatimit ushtarak.

3. “Subjekt i licencuar” është subjekti juridik, privat ose publik, që prodhon dhe tregton armë ushtarake ose merr pjesë në prodhimin e tregtimin e armatimit ushtarak, i cili ka marrë licencën përkatëse nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes për ushtrimin e veprimtarisë së tij.

4. “Prodhim” është procesi që përfshin projektimin e armatimit ushtarak, të sistemeve e të pajisjeve, zhvillimin e prototipave, montimin, ndërtimin, prodhimin në shkallë të vogël dhe në masë, standardizimin ushtarak, verifikimin e armëve të prodhuara, sistemin e sigurimit të cilësisë, kontrollit të cilësisë, modernizimin, mirëmbajtjen, demilitarizimin dhe riparimin e armatimit ushtarak, si dhe çdo aktivitet tjetër me të cilin synohet të përftohen produktet dhe pjesët e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake.

5. “Demilitarizim” është procesi i shndërrimit përfundimtar dhe të pakthyeshem të armatimit ushtarak, municionit dhe eksplozivëve, duke pamundësuar përdorimin e tyre për funksionet për të cilat janë krijuar. Demilitarizimi i mjeteve dhe pajisjeve ushtarake, si: tanke, avionë, anije, mjete të blinduara, është procesi i heqjes së të gjithë armatimit ushtarak dhe municionit prej tyre.

6. “Tregtim” është veprimtaria ekonomike, e cila nëpërmjet proceseve të shitjes dhe blerjes synon të transferojë armatimin ushtarak nga prodhuesi te përdoruesi fundor, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësve, brenda dhe jashtë vendit.

7. “Kërkim dhe zhvillim teknologjik i armatimit ushtarak” është ndërmarrja e proceseve novatore për zhvillimin e produkteve të reja ose përmirësimin e produkteve, shërbimeve dhe proceseve ekzistuese, duke përfshirë studimin, dizajnin e teknologjisë, zhvillimin e prototipave, testimin dhe përmirësimin e produkteve të reja.

8. “Praktika të mira tregtare” është tërësia e standardeve dhe procedurave të ndjekura gjatë prodhimit të armatimit ushtarak, të zhvilluara për të siguruar që aktivitetet tregtare të jenë etike, transparente dhe efikase, duke ruajtur gjithashtu sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

9. “Markim” është procesi i vendosjes së një shenje unike në formë kodi, pulle, etikete ose çdo forme tjetër unike identifikimi dhe individualizimi në armatimin ushtarak, nënproduktet ose produktet përfundimtare të tyre, që provon se prodhimi është kryer sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, me qëllim identifikimin dhe gjurmimin e tyre.

10. “Gjurmimi i armatimit ushtarak” është procesi i identifikimit dhe dokumentimit të lëvizjes dhe shpërndarjes në të gjitha fazat e prodhimit, blerjes, shitjes deri në asgjësimin ose përdorimin përfundimtar. Kjo përfshin regjistrimin e informacionit thelbësor, si: origjina, pronësia, shitja, blerja, transferimi, rrugët e transportit, vendet e magazinimit, si dhe çdo informacion tjetër që i shërben qëllimit të gjurmimit.

11. “Regjistri i posaçëm i subjekteve të përjashtuara” (RPSP) është regjistri zyrtar i mbajtur nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, ku pasqyrohet lista e individëve apo subjekteve juridike që kanë shkelur përcaktimet e këtij ligji, si dhe të atyre individëve që përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare, si dhe të sanksionuarit nga organizatat ndërkombëtare për kryerjen e transaksioneve financiare dhe operacionet tregtare në kundërshtim me ligjin dhe konventat ndërkombëtare rregullatore në këtë industri.

Neni 4 **Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj zbatohet për çdo subjekt që kryen veprimtari të licencuar për:

- a) prodhimin e armatimit ushtarak;
- b) zhvillimin e kërkimit shkencor dhe zhvillimin teknologjik mbi armatimin ushtarak;
- c) tregtimin e armatimit ushtarak.

2. Ky ligj zbatohet edhe për çdo strukturë shtetërore që kryen monitorimin, mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin e zbatimit të këtij ligji.

Neni 5 **Ndalim i përgjithshëm**

Në Republikën e Shqipërisë është i ndaluar:

a) prodhimi, tregtimi, kërkimi dhe zhvillimi i armatimit ushtarak, në kundërshtim me konventat dhe traktatet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) prodhimi dhe tregtimi, në çdo formë, i armëve dhe teknologjive të armëve biologjike, kimike dhe bërthamore.

Neni 6 **Tregtimi**

Për qëllime të këtij ligji, tregtia e armatimit ushtarak kryhet nga subjektet e licencuara, duke përfshirë edhe:

bashkëpunimin tregtar, teknik e prodhues;

b) ndërmjetësimin dhe shërbime të tjera në tregtinë e armatimit ushtarak;

c) projektimin, ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve për prodhimin e armatimit ushtarak;

ç) shitblerjen e të drejtave mbi teknologjinë në fushën e prodhimit të armatimit ushtarak.

Neni 7 **Parime të përgjithshme**

1. Subjektet e licencuara zbatojnë standarde të larta të sigurisë e të mbrojtjes së interesit publik dhe marrin të gjitha masat për të zbatuar rregullat e këtij ligji dhe standardet e tjera të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi në të gjitha fazat e zhvillimit të veprimtarisë, me qëllim parandalimin e aksidenteve dhe të keqpërdorimit të armatimit ushtarak.

2. Subjektet e licencuara bashkëpunojnë ngushtë me autoritetet e sigurisë kombëtare e ndërkombëtare për të parandaluar dhe menaxhuar çdo rrezik potencial ndaj sigurisë që mund të rrjedhë nga aktiviteti i tyre.

3. Subjektet e licencuara janë të detyruara të bashkëpunojnë me autoritetet përgjegjëse për të siguruar që të gjitha aktivitetet e tyre të zhvillohen në përputhje me standardet e nevojshme të transparencës e të qëndrueshmërisë, duke garantuar një nivel të lartë të llogaridhënies dhe integritetit në veprimtarinë e tyre.

4. Të gjitha subjektet shtetërore dhe private, të cilat ushtrojnë veprimtari brenda fushës së zbatimit të këtij ligji, ushtrojnë përgjegjësinë dhe kujdesin e duhur për parandalimin e ndalimin e akteve korruptive, të përvetësimit të paligjshëm të interesave, të shpërdorimit dhe trafikimit të armatimit ushtarak, të përhapjes së tyre në masë, të akumulimit të paligjshëm të armëve që mund të përdoren nga rrjetet e krimit të organizuar apo të përdoren për akte terrorizmi, agresioni të brendshëm apo ndërkombëtar ose shkelje të rënda të së drejtës ndërkombëtare.

5. Autoritetet shtetërore dhe subjektet e licencuara ushtrojnë aktivitetin e tyre duke prioritetizuar nxitjen e teknologjive të reja dhe inovacionit në fushën e mbrojtjes dhe bashkëpunojnë, kur është nevoja, në funksion të krijimit të një mjedisi të favorshëm për kërkimin shkencor dhe zhvillimin teknologjik.

Neni 8 **Praktika të mira tregtare**

Praktikat e mira tregtare përfshijnë:

a) respektimin e plotë të ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare që rregullojnë tregtinë e armëve, duke përfshirë kontrollet e eksportit dhe sanksionet ndërkombëtare;

b) raportimin e qartë dhe të saktë të të dhënave tregtare e financiare për të shmangur çdo lloj keqkuptimi ose dyshimi mbi veprimet korruptive ose të paligjshme;

c) sigurimin që të gjitha armët dhe teknologjitë ushtarake mbrohen nga aksesimi i paautorizuar gjatë prodhimit, magazinimit dhe transportit;

ç) mbrojtjen e teknologjive të një rëndësie të veçantë ushtarake nga kopjimi ose shpërndarja e paautorizuar për të siguruar avantazhet strategjike dhe tregtare;

d) zbatimin e standardeve të larta etike në marrëdhëniet me klientët dhe furnizuesit, përfshirë refuzimin e ryshfetit dhe korruptimit;

dh) zbatimin e praktikave që minimizojnë ndikimin mjedisor të prodhimit dhe shkatërrimit të armatimit;

e) angazhimin me komunitetet lokale dhe kontributin në zhvillimin e tyre ekonomik e social, veçanërisht në zonat ku zhvillohen aktivitete të prodhimit të armëve;

ë) sigurimin që të gjithë punonjësit marrin trajnimin e nevojshëm për të zbatuar praktikën e mira tregtare dhe për të menaxhuar teknologjitë e reja e materialet me përgjegjësi.

Neni 9

Detyrimi për krijimin e rezervave të armatimeve dhe pajisjeve teknologjike në kushte të veçanta

1. Në rastin e gjendjes së luftës ose në kushtet e një rreziku të afërt dhe konkret të një agresioni ushtarak ndaj Republikës së Shqipërisë ose aleatëve të saj strategjikë, subjektet e licencuara kanë detyrimin që të sigurojnë një rezervë të caktuar armatimesh dhe pajisjesh teknologjike për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Detyrimet, që duhet të zbatohen subjektet e licencuara sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

3. Subjektet e licencuara janë të detyruara të plotësojnë kërkesën sipas pikës 1 të këtij neni, në mënyrë të menjëhershme e të plotë, në përputhje me ligjin dhe udhëzimet e autoriteteve përgjegjëse për rregullimin e industrisë së mbrojtjes.

KREU II

KRIJIMI DHE KOMPETENCAT E AGJENCISË SË INDUSTRIË SË MBROJTJES

Neni 10

Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes

1. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes (AIM), këtu e në vijim “Agjencia”, është autoriteti shtetëror përgjegjës për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e industrisë së prodhimit, magazinimit, transportimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armatimit ushtarak.

2. Agjencia është institucion në varësi të ministrit të Mbrojtjes, me statusin e personit juridik publik, me seli në Tiranë.

3. Agjencia financohet nga buxheti i shtetit dhe burime të tjera të ligjshme.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë emërohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

5. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes.

6. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë.

Neni 11

Kompetencat e Agjencisë së Industrisë së Mbrojtjes

Agjencia kryen funksionet dhe detyrat si më poshtë:

a) lëshon, rinovon, pezullon dhe revokon licencat për subjektet që merren me prodhimin dhe tregtimin e armatimit ushtarak;

b) mban dhe përditëson regjistrin e subjekteve të licencuara dhe të armatimit ushtarak të prodhuar, të zhvilluar apo të tregtuar në Republikën e Shqipërisë;

c) përcakton rregullat specifike që subjektet e licencuara duhet të ndjekin për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e produkteve e të shërbimeve të tyre, duke përfshirë kriteret për testimin dhe certifikimin e armatimit ushtarak, përpara se ato të hyjnë në treg;

ç) bashkëpunon ngushtë me homologët e saj ndërkombëtarë dhe angazhohet në marrëveshje bashkëpunimi për shkëmbimin e informacionit, praktikave më të mira dhe përforcimin e kapaciteteve në fushën e kontrollit të armatimit ushtarak;

d) bashkëpunon me subjektet e licencuara për të zhvilluar standarde dhe praktika të mira në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji;

dh) bashkëpunon me Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe subjekte të tjera private e shtetërore, me qëllim nxitjen, promovimin dhe rritjen e inovacionit e të zhvillimit teknologjik në fushën e mbrojtjes e të prodhimit të armatimit ushtarak;

e) parashikon mekanizma bashkëpunimi midis Agjencisë dhe subjekteve të tjera shtetërore për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e përpjekjeve për mbikëqyrjen e tregut të armatimit ushtarak;

ë) bashkëpunon dhe ndan informacion me institucionet dhe entitetet ndërkombëtare që mbikëqyrin kontrollin e armëve dhe sigurinë globale, duke kontribuar në përpjekjet ndërkombëtare për parandalimin e përhapjes së paligjshme të armatimit ushtarak;

f) monitoron dhe garanton që legjislacioni kombëtar dhe procedurat e zbatuara nga subjektet e licencuara janë në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të ndërmarra nga Republika e Shqipërisë;

g) mbikëqyr zbatimin e legjislacionit për prodhimin dhe tregtimin e armëve dhe armatimit ushtarak nga ana e subjekteve të licencuara;

gj) kryen inspektime të rregullta dhe monitoron aktivitetet e subjekteve të licencuara për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin, veçanërisht me kërkesat e sigurisë e të cilësisë;

h) mban dhe publikon regjistrin e posaçëm të subjekteve të përjashtuara;

i) merr masa administrative për subjektet e licencuara, që gjenden në shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi për prodhimin dhe tregtimin e armatimit ushtarak;

j) siguron transparencë në veprimtarinë e saj rregullatore, duke publikuar raporte të rregullta, statistika dhe analiza mbi gjendjen e industrisë së armatimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë;

k) funksionon si një *“one stop shop”* për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që paraqiten nga subjektet e këtij ligji.

KREU III

ZHVILLIMI I AKTIVITETEVE TË LICENCUARA

Neni 12

Licencimi

1. Prodhimi, magazinimi, transportimi dhe tregtimi i armatimit ushtarak kryhen vetëm nga subjektet e pajisura me licencën përkatëse të lëshuar nga Agjencia.

2. Subjektet, që kryejnë veprimtari në fushën e prodhimit e të tregtimit të armatimit ushtarak në Shqipëri, përmbushin kriteret specifike për marrjen e licencës së aktivitetit.

3. Subjektet, që kërkojnë licencim, duhet të paraqesin vërtetim të kapaciteteve të caktuara financiare e teknike për përputhshmërinë me standardet e sigurisë, cilësisë dhe besueshmërisë, respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit, shëndetit dhe jetës së njerëzve, si dhe për mbrojtjen e sigurinë e punonjësve të tyre.

4. Subjektet, që paraqesin kërkesë për licencë apo autorizim, ndërmarrin detyrimin për të vepruar në përputhshmëri me legjislacionin kombëtar dhe detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe detyrimin për t'u angazhuar në praktika të mira tregtare.

5. Këshilli i Ministrave përcakton llojet e licencave, kriteret e detajuara dhe procedurat e licencimit të subjekteve, rinovimit, pezullimit dhe revokimit të tyre, si dhe tarifat e aplikimit për licencim, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

Neni 13

Rinovimi, pezullimi dhe revokimi i licencave

1. Subjektet e licencuara paraqesin pranë Agjencisë kërkesën për rinovimin e licencës së tyre përpara përfundimit të afatit të saj. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për rinovim, Agjencia sigurohet që subjekti kërkuar, përgjatë kohëzgjatjes së licencës, ka garantuar në mënyrë të vazhdueshme përputhshmërinë e aktivitetit të tij me dispozitat ligjore dhe rregullatore për prodhimin dhe tregtimin e armatimit ushtarak.

2. Rinovimi i licencës u nënshtrohet të njëjtave procedura të marrjes së licencës.
3. Agjencia pezullon licencën në rastet kur:
 - a) subjekti shkel kushtet e licencës;
 - b) subjekti nuk raporton dhe nuk merr miratim për ndryshimet mbi kushtet për të cilat është dhënë licenca;
 - c) gjatë kontrolleve inspektuese nga Agjencia konstatohet se procesi i prodhimit nuk është në përputhje me kërkesat e cilësisë e të sigurisë;
 - ç) konstatohet se sistemi i gjurmimit nuk është funksional sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
4. Në rastet e pezullimit të licencës, subjektit i lihet një afat 45-ditor për plotësimin e mangësive të konstatuara. Në përfundim të këtij afati, në rast të mosplotësimit të mangësive Agjencia vendos për revokimin e licencës.
5. Agjencia revokon licencën në rastet kur:
 - a) subjekti angazhohet në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare;
 - b) subjekti përdor në mënyrë të paautorizuar armët;
 - c) subjekti nuk respekton kriteret e sigurisë dhe cilësisë;
 - ç) konstatohet se licenca është lëshuar në bazë të të dhënave të rreme;
 - d) subjekti pengon inspektimin dhe kontrollin nga autoritetet përgjegjëse;
 - dh) subjekti, brenda afatit të caktuar, nuk i ka eliminuar parregullsitë ose paligjshmëritë e konstatuara nga Agjencia;
 - e) subjekti pa arsye të ligjshme vepron në kundërshtim me pikën 3 të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 14

Kërkimi dhe zhvillimi teknologjik

1. Aktivitetet e kërkimit e të zhvillimit teknologjik kryhen në mënyrë ekskluzive nga subjektet e pajisura me autorizimin përkatës nga Agjencia.
2. Subjektet, të cilat kërkojnë të pajisen me autorizim për zhvillimin e aktiviteteve të kërkimit e të zhvillimit teknologjik, garantojnë respektimin e legjislacionit që mbron të drejtat e autorit, si dhe kryerjen e kësaj veprimtarie, duke respektuar standardet kërkimore dhe direktivat që lidhen me integritetin dhe përgjegjësinë gjatë kryerjes së kërkimeve e të eksperimenteve.
3. Këshilli i Ministrave përcakton llojet e autorizimeve, kriteret dhe procedurën për dhënien e tyre, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

Neni 15

Regjistrimi dhe raportimi

1. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes mban një regjistër, me akses ekskluziv, ku paraqiten të dhëna të sakta e të përditësuara të të gjitha armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake të prodhuara, të magazinuara, të tregtuara, të importuara ose të eksportuara.
2. Subjektet e licencuara janë të detyruara të regjistrojnë të gjitha aktivitetet e tyre që lidhen me prodhimin, tregtimin, si dhe eksport - importin e armatimit ushtarak në regjistrin e mbajtur nga Agjencia.
3. Subjektet e licencuara janë të detyruara të raportojnë rregullisht pranë Agjencisë për çdo ndryshim në aktivitetet e prodhimit ose tregtimit, në strukturën e tyre të pronësisë ose në teknologjitë e përdorura.
4. Format i regjistrit, përmbajtja e raportimit dhe afatet raportuese përcaktohen nga Agjencia.

Neni 16

Markimi dhe gjurmimi

1. Markimi bëhet nëpërmjet shenjës unike në formë kodi, pulle, etikete ose çdo forme tjetër unike identifikimi e individualizimi në armatimin ushtarak, nënproduktet ose produktet përfundimtare të tyre, që provon se prodhimi është kryer sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, me qëllim identifikimin dhe gjurmimin e tyre.

2. Gjurmimi bëhet nëpërmjet sistemit të gjurmimit, të ngritur nga subjektet e licencuara, për çdo njësi të prodhuar, të tregtuar, të eksportuar, duke mundësuar identifikimin dhe gjurmimin e armatimit. Ky sistem duhet të jetë i ngritur në mënyrë elektronike dhe të jetë i aksesueshëm në çdo kohë nga Agjencia. Subjektet e licencuara janë të detyruara të markojnë produktin, që është objekt i veprimtarisë së tyre, dhe të zbatojnë të gjithë legjislacionin lidhur me markimin dhe gjurmimin.

3. Kërkesat për gjurmueshmërinë, si dhe rregullat për elementet, etiketën apo pullën unike të markimit apo forma të tjera të identifikimit e të individualizimit të armatimit ushtarak, procedura dhe mënyra e markimit dhe gjurmimit, si dhe autoriteti apo pala e autorizuar për realizimin e markimit e të gjurmueshmërisë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.

Neni 17

Mbikëqyrja mbi gjurmimin

1. Agjencia monitoron vendosjen e shenjave unike për identifikimin dhe gjurmimin e armatimit ushtarak në të gjitha fazat e prodhimit deri te përdoruesi fundor.

2. Subjektet e licencuara, sipas kuptimit të këtij ligji, kanë detyrimin të hedhin të dhënat për identifikimin dhe gjurmimin e armëve në regjistrin elektronik të mbajtur nga Agjencia, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Agjencia akseson regjistrin për qëllime kontrolli dhe inspektimi të aktiviteteve të zhvilluara nga subjektet e licencuara.

Neni 18

Siguria

1. Subjektet, që prodhojnë, tregtojnë dhe shpërndajnë armë ushtarake, sipas këtij ligji, hartojnë dhe zbatojnë një rregullore të brendshme, ku parashikohen masat dhe procedurat për të garantuar:

a) mbrojtjen dhe sigurinë e jetës së njerëzve, mjedisit dhe interesave të tjera publike;

b) mbrojtjen dhe sigurinë e shëndetit e të jetës së personelit;

c) sigurinë e produkteve e të pajisjeve të prodhimit, të mjeteve dhe të makinerive speciale, objekteve ku zhvillohen të gjitha fazat e prodhimit, testimit, magazinimit dhe shpërndarjes së armatimit ushtarak;

ç) mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave dhe dokumentacionit që lidhet me prodhimin, projektet e zhvillimit, kërkimin dhe zhvillimin teknologjik e industrial, si dhe informacionin mbi marrëdhëniet financiare e të biznesit;

d) ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në rast emergjence në procesin e prodhimit, tregtisë dhe transportit të armatimit ushtarak.

2. Subjektet, që ushtrojnë veprimtari në fushën e këtij ligji, detyrohen të vlerësojnë në mënyrë periodike, përmes raporteve audituese, garantimin e standardeve për menaxhimin e rreziqeve specifike që lidhen me çdo fazë të prodhimit dhe magazinimit të armatimit ushtarak.

3. Subjektet detyrohen që gjatë veprimtarisë së tyre të veprojnë në përputhje me standardet e njohura e praktikat e mira, si dhe legjislacionin kombëtar, rregulloret e Bashkimit Evropian dhe embargot e sanksionet e vendosura nga institucionet ndërkombëtare me të cilat Republika e Shqipërisë ka lidhur marrëveshje.

4. Subjektet, që prodhojnë apo marrin pjesë në prodhimin, tregtimin ose transportin e armatimit ushtarak, detyrohen të garantojnë magazinimin e sigurt, në mënyrë që të parandalojnë humbjen ose dëmtimin e armatimit ushtarak. Në rast të humbjes apo dëmtimit të armatimit ushtarak, subjektet, menjëherë dhe jo më vonë se 24 orë nga ngjarja, njoftojnë Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes.

5. Ministri i Mbrojtjes, me propozimin e Agjencisë, miraton standardet minimale të sigurisë, të detyrueshme për subjektet e licencuara.

Neni 19

Mbrojtja e punonjësve dhe standardet e punës

Agjencia përcakton rregullat e posaçme për industrinë ushtarake, me qëllim garantimin e kushteve të sigurta të punës, sigurinë fizike në vendin e punës dhe promovimin e standardeve të larta etike e profesionale.

Neni 20

Infrastruktura digjitale dhe siguria kibernetike

1. Subjektet, që veprojnë në fushën e prodhimit e të tregtimit të armatimit ushtarak, detyrohen të zbatojnë legjislacionin në fuqi për sigurinë kibernetike për të mbrojtur të dhënat dhe informacionet që trajtohen në sistemet e tyre të komunikimit e të informacionit.

2. Agjencia, me qëllim zhvillimin e standardeve dhe praktikave të mira në fushën e sigurisë kibernetike, bashkëpunon me strukturat përgjegjëse ushtarake e civile për sigurinë kibernetike në Ministrinë e Mbrojtjes dhe autoritetin kombëtar, përgjegjës për sigurinë kibernetike.

3. Në rast se subjektet trajtojnë informacion të klasifikuar, ato zbatojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar.

4. Agjencia kontrollon zbatimin e masave e të rekomandimeve të përcaktuara nga autoritetet kompetente për sigurinë kibernetike dhe për sigurinë e informacionit të klasifikuar.

KREU IV

NDËRVEPRIMI ME SUBJEKTET PUBLIKE

Neni 21

Trajtimi i informacionit të klasifikuar, sekretit tregtar dhe sekretit industrial

1. Të gjitha subjektet, që veprojnë sipas këtij ligji, janë të detyruara të trajtojnë çdo informacion të klasifikuar sekret tregtar dhe sekret industrial në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar dhe të drejtat e pronësisë intelektuale e industriale.

2. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes dhe institucionet e tjera shtetërore zbatojnë masa të rrepta për të garantuar mbrojtjen e këtyre të dhënave dhe për të parandaluar zbulimin ose keqpërdorimin e tyre, bazuar në legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar, si dhe për mbrojtjen e sekretit tregtar e të sekretit industrial.

Neni 22

Bashkëpunimi me Qendrën e Inovacionit, Sigurisë dhe Mbrojtjes

Subjektet e licencuara bashkëpunojnë me Qendrën e Inovacionit, Sigurisë dhe Mbrojtjes për të nxitur inovacionin dhe zhvillimin teknologjik në industrinë e mbrojtjes. Ky bashkëpunim ka për objekt projekte të përbashkëta kërkimore, zhvillimin e teknologjive të reja dhe shkëmbimin e njohurive e të ekspertizës.

Neni 23

Patentimi dhe regjistrimi i markave, produkteve dhe shpikjeve

1. Subjektet e licencuara sipas këtij ligji kanë të drejtë të regjistrojnë patentën, markën tregtare ose shpikjen, që lidhet me prodhimin dhe zhvillimin e armatimit ushtarak, në zyrën përkatëse të patentave e të markave tregtare, me qëllim mbrojtjen ligjore të pronësisë intelektuale dhe nxitjen e inovacionit e të konkurrencës së shëndetshme në këtë sektor. Regjistrimi i markave dhe patentave për produktet ushtarake ndjek të njëjtat procedura si për çdo produkt tjetër, duke përfshirë regjistrimin nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

2. Për produktet e krijuara nga subjektet e licencuara sipas këtij ligji, që përfshijnë teknologji të një rëndësie të veçantë ose sekrete, agjencia mbajtëse e regjistrimit parashikon procedura dhe rregullore shtesë që lidhen me sigurinë kombëtare. Në këto raste, kërkohet miratimi ose vlerësimi nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes, përpara se të lejohet regjistrimi i një patente ose marke tregtare, për të siguruar që nuk cenohet siguria kombëtare.

Neni 24

Mbështetja për trajnimin dhe zhvillimin e punonjësve

Subjektet, të cilat përfitojnë nga lehtësitë sipas këtij ligji, janë të detyruara të investojnë në trajnimin dhe zhvillimin profesional të punonjësve të tyre, në fushat që lidhen me sigurinë, menaxhimin e cilësisë dhe teknologjive të reja, duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve njerëzore në sektorin e industrisë së mbrojtjes.

Neni 25

Mbështetja institucionale

1. Entet shtetërore njohin dhe zbatojnë përfitimet, lehtësitë tatimore dhe doganore dhe çdo lehtësi tjetër që parashikohet nga ky ligj për subjektet që operojnë në industrinë e prodhimit të armatimit ushtarak.

2. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes do të funksionojë si një “one stop shop” për zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që paraqiten nga subjektet e këtij ligji, duke garantuar trajtimin e informacionit në përputhje me ligjin për informacionin e klasifikuar dhe ruajtjen e sekretit tregtar e industrial.

Neni 26

Lehtësira fiskale dhe lehtësira të tjera

1. Subjekti i licencuar në industrinë e prodhimit të armatimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë përfiton lehtësira, duke përfshirë:

- a) normë të tatimit mbi të ardhurat korporative 0% për 10 vjetët e parë pas fillimit të aktivitetit;
- b) shkallë të reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar prej 10% për furnizimin/shitjet e armatimit ushtarak;
- c) përjashtim nga taksat doganore për mallrat, të cilat shërbejnë drejtpërdrejt për prodhimin e armatimit ushtarak. Lista e mallrave të përjashtuara përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Subjekti, që do të kryejë aktivitet në industrinë ushtarake nëpërmjet partneritetit të krijuar me shoqërinë shtetërore të prodhimit të armatimit ushtarak në Republikën e Shqipërisë, përveç sa është parashikuar në pikën 1, kualifikohet për lehtësi të tjera, që përfshijnë:

- a) procedura të përshpejtuara për licencimin dhe regjistrimin e veprimtarisë, sipas legjislacionit në fuqi;
- b) mbështetje për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ndihmëse, si: rrugë, ujësjellës-kanalizime, energji elektrike dhe telekomunikacion, të cilat janë thelbësore për funksionimin e aktivitetit të subjektit;
- c) qasje në fonde dhe programe mbështetëse për kërkim dhe zhvillim në fushën e teknologjive të mbrojtjes;
- ç) mbështetje dhe bashkëpunim në projekte kërkimore, zhvillimin e teknologjive të reja dhe shkëmbimin e njohurive e të ekspertizës nga Qendra e Inovacionit, Sigurisë dhe Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes.

Neni 27

Kriteret dhe procedurat e aplikimit dhe miratimit për lehtësitë

1. Për të përfituar nga lehtësitë e parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të këtij ligji, subjekti aplikon pranë Agjencisë.

2. Në dokumentacionin e nevojshëm, që paraqet subjekti i interesuar për përfitimin e lehtësive, përfshihen:

- a) formulari standard i aplikimit, i plotësuar dhe i firmosur nga përfaqësuesi ligjor i subjektit;
- b) kopja e certifikatës së regjistrimit të subjektit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- c) kopja e plotë e planit të biznesit afatshkurtër 3-vjeçar;

ç) pasqyra financiare të audituara për të paktën 3 vjetët e fundit në vendin e origjinës së subjekteve aplikuese ose, në rast të subjekteve të reja, deklaratat financiare e audituesit të miratuar;

d) dokumentacioni, që përshkruan nevojat për infrastrukturë ndihmëse;

dh) lista e punonjësve të planifikuar për punësim dhe programi i trajnimit për kualifikimin e tyre;

e) vërtetimi i gjendjes gjyqësore ose një dokument i lëshuar nga një autoritet kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

3. Përjashtohet nga mbështetja dhe lehtësitë e parashikuara në këtë ligj çdo subjekt prodhues dhe tregtar, çdo person që është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak i subjektit prodhues e tregtar, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse apo kontrolluese brenda tij, që është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për pjesëmarrje ose financim në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste, pastrim parash ose financim të terrorizmit, vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, gjenocid, torturë, vrasje, vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike, armëmbajtje pa leje, tregti të paligjshme armësh, krime ushtarake, sulme kibernetike, organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit e shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve, si dhe shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

4. Agjencia vlerëson aplikimet dhe pas koordinimit me institucionet e tjera shtetërore, me të cilat lidhet kërkesa për lehtësi, vlerëson lehtësirat që mund të përfitojë subjekti, brenda një afati prej 30 ditësh.

5. Raporti i Agjencisë mbi lehtësirat dhe propozimet përkatëse i paraqitet Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë për shqyrtim dhe miratim.

6. Kriteret e tjera, procedurat dhe dokumentacioni që duhet të plotësojnë subjektet aplikante për përfitim nga lehtësirat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU V

MARRËDHËNIET MË PALËT E TRETA

Neni 28

Nënkontraktimi i aktivitetit nga subjektet e licencuara

1. Çdo subjekt i licencuar sipas këtij ligji, që kërkon të nënkontraktojë çdo pjesë të aktivitetit të tij në fushën e prodhimit të armatimit ushtarak, duhet të marrë autorizim paraprak nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes.

2. Kërkesa për autorizim duhet të përmbajë një përshkrim të detajuar të pjesës së aktivitetit që do të nënkontraktohet, si dhe informacionin e plotë mbi subjektin e nënkontraktuar.

3. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes vlerëson kërkesën bazuar në kriteret e sigurisë kombëtare dhe jep përgjigje brenda një afati kohor të caktuar.

4. Autorizimi mund të refuzohet ose të kushtëzohet në varësi të nevojave të sigurisë kombëtare dhe të standardeve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

5. Rregullat dhe procedurat për vlerësimin dhe lejimin e nënkontraktimit përcaktohen nga Agjencia.

Neni 29

Përjashtimi i transaksioneve të caktuara

Për të kontrolluar rrezikun që lidhet me shpërdorimin, trafikimin, korrupsionin, përhapjen, favorizimin e terrorizmit dhe krimin të organizuar, si dhe për të siguruar respektimin e sanksioneve ndërkombëtare, subjektet e licencuara sipas këtij ligji, nuk kryejnë transaksione tregtare, në rastet kur:

a) është e pamundur të identifikohen qartësisht të gjitha palët e përfshira në transaksion;

b) është e pamundur të identifikohen të gjitha fazat gjeografike të transportit;

c) vendi i destinacionit është subjekt i një regjimi të zbatueshëm embargo të vendosur nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ose Bashkimi Evropian.

KREU VI

MBIKËQYRJA DHE KONTROLLI

Neni 30

Mbikëqyrja e subjekteve përfituese dhe masat administrative

1. Agjencia mbikëqyr përputhshmërinë e subjekteve që përfitojnë nga lehtësitë me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj e në aktet nënligjore të tij.
2. Subjektet, që përfitojnë nga lehtësitë, janë të detyruara të paraqesin raporte të rregullta për performancën e tyre financiare e operacionale, si dhe për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në planin e tyre të biznesit. Rregullat mbi këto raportime përcaktohen nga Agjencia.
3. Në rast se Agjencia gjatë verifikimit periodik apo të rastit konstaton se subjekti përfitues nuk plotëson më kushtet për përfitimin e lehtësive, ajo njofton subjektin brenda 7 ditëve nga konstatimi, duke i komunikuar një afat prej 30 ditësh nga marrja e njoftimit për të adresuar dhe korrigjuar mospërputhshmërinë e konstatuar. Gjatë afatit 30-ditor, subjekti përfitues duhet të paraqesë prova që tregojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të tij.
4. Nëse subjekti përfitues nuk arrin të korrigjojë mospërputhshmërinë brenda afatit të caktuar, Agjencia vendos për përjashtimin e subjektit nga lehtësitë e dhëna.
5. Në rastet e përjashtimit nga lehtësitë, subjekti është i detyruar të rikthejë çdo përfitim nga data e konstatuar e mospërputhshmërisë. Agjencia do të përcaktojë saktësisht shumën e përfitimeve që duhet të kthehen dhe do t'i komunikojë subjektit detyrimet përkatëse.
6. Subjekti ka të drejtë të ankimojë vendimin e agjencisë në përputhje me nenin 35 të këtij ligji.
7. Në rast se pas përjashtimit nga lehtësitë, subjekti arrin të plotësojë sërish kushtet e përcaktuara, ai mund të paraqesë një kërkesë të re për rivendosjen e lehtësive, e cila do të shqyrtohet sipas procedurave të zakonshme të aplikimit.

Neni 31

Inspektimi dhe monitorimi

1. Agjencia kryen inspektime të rregullta, me dhe pa paralajmërim, në subjektet e licencuara për të vërtetuar përputhshmërinë me legjislacionin, rregulloret dhe standardet e sigurisë e të mjedisit.
2. Rregulloret lidhur me objektin, përmbajtjen, metodën, vendin, procedurën, standardet e inspektimit dhe çështje të tjera të lidhura sipas pikës 1 të këtij neni miratohen nga Këshilli i Ministrave.
3. Inspektimi dhe monitorimi kryhen vetëm sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 32

Kontrollet e eksportit dhe importit

Eksporti dhe importi i armatimit ushtarak kryhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë në Republikën e Shqipërisë.

KREU VII

MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 33

Masa administrative

1. Agjencia merr masa administrative për subjektet e licencuara, që gjenden në shkelje të dispozitave të këtij ligji, të akteve nënligjore, si dhe rregulloreve përkatëse në zbatim të tij.
2. Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga subjekti i licencuar, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative:
 - a) përfshihet në testimin e armatimit ushtarak ose aktivitetet e specializuara pa miratim nga Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes;

b) prodhon ose tregon armatim ushtarak, që nuk është testuar e markuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

c) prodhuesi i armëve dhe pajisjeve ushtarake nuk i ka njoftuar organet kompetente shtetërore për zhdukjen ose dëmtimin e armëve e të pajisjeve ushtarake ose për zbulimin e të dhënave sekrete;

ç) ndryshon dokumentacionin teknik për prodhimin e armëve e të pajisjeve ushtarake në pronësi të shtetit shqiptar dhe ua kalon palëve të treta, pa pëlqimin paraprak të qeverisë së Republikës së Shqipërisë;

d) nuk e njofton Agjencinë e Industrisë së Mbrojtjes me shkrim brenda një afati prej 15 ditësh për të gjitha ndryshimet e rëndësishme në të dhënat e parashtruara me rastin e paraqitjes së kërkesës për dhënien e licencës për prodhimin e armëve e të pajisjeve ushtarake;

dh) nuk mban evidencë për armët dhe pajisjet ushtarake të prodhuara që përmbajnë të dhëna për llojin, sasinë, numrat serialë dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për identifikim, klientët dhe datat e dorëzimit;

e) nuk zbaton masat e sigurisë në prodhimin e armëve dhe pajisje në përputhje me Planin e Sigurisë Industriale për prodhimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake;

ë) nuk mban dokumentacion teknik për prodhimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake;

f) sistemi i gjurmimit nuk identifikon produktin në të gjitha fazat e tij;

g) prodhuesi i armëve dhe pajisjeve ndryshon qëllimin, njësitë prodhuese dhe teknologjike në kapacitetet për prodhimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake, pa pëlqimin paraprak të Agjencisë;

gj) nuk miraton një rregullore të përgjithshme që të përmbajë planin e veprimit për masat e sigurisë ose nuk vepron në përputhje me këtë rregullore;

h) nuk u njofton masat e parashikuara në rregullore të gjithë personave që kryejnë aktivitetet me armatim ushtarak për llogari të tij ose nuk u ofron atyre trajnimin për të vepruar në rast aksidenti;

i) nuk garanton mbrojtje të përhershme fizike ose teknike të ambienteve për prodhimin ose magazinimin e armatimit ushtarak;

j) lejon një person, i cili nuk është i kualifikuar teknikisht, nuk zotëron vërtetim të aftësisë, nuk punon nën mbikëqyrjen e personit përgjegjës teknikisht të kualifikuar dhe nuk ka deklaruar me shkrim se i njeh rreziqet e rregullat e sigurisë në vendin e punës, të përfshihet në aktivitete ndihmëse lidhur me prodhimin, tregtimin, transportin, magazinimin;

k) magazinon armatim ushtarak në struktura dhe ambiente që nuk janë krijuar për magazinimin e tyre ose i magazinon ato në sasi që tejkalojnë kapacitetin maksimal të magazinës;

l) është përgjegjës për mbajtjen e të dhënave për gjurmimin e artikujve piroteknikë dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore;

ll) angazhohet në transportin e armatimit ushtarak, duke mos respektuar rregullat për transportin e tyre;

m) pengon inspektorin që të kryejë mbikëqyrjen inspektuese ose nuk i siguron atij akses në dokumentacionin e kërkuar dhe/ose nuk i jep informacionin dhe të dhënat e nevojshme;

n) nuk arrin të korrigjojë mospërputhshmërinë brenda afatit të caktuar, Agjencia vendos për përjashtimin e subjektit nga lehtësitë e dhëna.

3. Agjencia vendos gjobë ndaj subjekteve tregtare, të përfshira në prodhimin e armatimit ushtarak, si më poshtë:

a) për shkelje të parashikuara nga shkronjat “a”, “b”, “c”, dhe “ç” të pikës 2 të këtij neni, nga 5 000 000 (pesë milionë) - 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekë;

b) për shkelje të parashikuara nga shkronjat “d”, “dh”, “e”, “ë” dhe “f” të pikës 2 të këtij neni, nga 500 000 (pesëqind mijë) - 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

c) për shkelje të parashikuara nga shkronjat “g”, “gj”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, nga 200 000 (dyqind mijë) - 2 000 000 (dy milionë) lekë;

ç) për shkelje të parashikuara nga shkronjat “k”, “l”, “ll”, dhe “m” të pikës 2 të këtij neni, nga 100 000 (njëqind mijë) - 500 000 (pesëqind mijë) lekë.

4. Subjekteve përsëritëse të shkeljeve të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 2 të këtij neni, përveç gjobës, mund t’u caktohet një masë shtesë që ndalon prodhimin e armatimit ushtarak.

Masa shtesë e përcaktuar vendoset për një periudhë deri në 3 vjet nga data e vendimit përfundimtar.

5. Agjencia, përveç sanksioneve administrative të parashikuara në këtë nen, mund t'u pezullojë ose revokojë licencën e dhënë këtyre subjekteve kur ata përsërisin shkeljet apo nuk marrin masa për t'i korrigjuar ato.

6. Në rastet e hetimit penal për vepra penale të lidhura me aktivitetin e prodhimit të armatimit ushtarak apo me sigurinë kombëtare, licenca e lëshuar nga Agjencia mund të pezullohet deri në përfundim të hetimit të çështjes penale.

Neni 34

Regjistri i posaçëm i subjekteve të përjashtuara

1. Agjencia mban dhe publikon një regjistrë të posaçëm të subjekteve të përjashtuara, që janë gjetur në shkelje të dispozitave referuese të këtij ligji apo që nëpërmjet veprimtarisë së tyre të prodhimit apo tregtimit të armatimit ushtarak kanë cenuar sigurinë kombëtare e ndërkombëtare.

2. Këshilli i Ministrave përcakton rastet, kushtet dhe procedurat e marrjes së vendimit për përfshirjen e subjektit në regjistrin e posaçëm të subjekteve të përjashtuara.

Neni 35

Ankimi

1. Subjektet e licencuara dhe individët kanë të drejtën e ankimit administrativ sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Administrative për vendimet e marra nga Agjencia.

2. Për shqyrtimin e ankesave të subjekteve përkundrejt vendimmarrjes së Agjencisë në Ministrinë e Mbrojtjes ngrihet Komisioni i Ankimit Administrativ. Ky komision ngrihet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

3. Pas shterimit të ankimit pranë Komisionit të Ankimit Administrativ, subjekti i licencuar i drejtohet gjykatës kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.

KREU VIII

KOMITETI I MBROJTJES DHE SIGURISË

Neni 36

Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë

1. Me qëllim mbrojtjen e garantimin e interesave të vendit në fushën e sigurisë e të mbrojtjes, si dhe nxitjen e zhvillimit të industrisë ushtarake, ngrihet dhe funksionon Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë.

2. Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë është organ administrativ kolegjal pranë Këshillit të Ministrave, i cili funksionon sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje këta anëtarë:

- ministrin e Mbrojtjes;
- ministrin përgjegjës për punët e brendshme;
- ministrin përgjegjës për politikën e jashtme;
- ministrin përgjegjës për financat;
- ministrin përgjegjës për ekonominë;
- ministrin përgjegjës për çështjet e infrastrukturës e të transportit;
- ministrin përgjegjës për drejtësinë;
- Avokatin e Përgjithshëm të Shtetit.

4. Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë fton të marrin pjesë në mbledhjet e tij, pa të drejtë vote, përfaqësues të institucioneve apo enteve të tjera shtetërore, në rastet kur vlerëson se opinionet dhe mendimet e tyre duhet të paraqiten përpara vendimmarrjes për çështjen në proces shqyrtimi.

5. Komiteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë ka këto përgjegjësi:

- a) monitoron garantimin e interesave kombëtarë në fushën e mbrojtjes e të sigurisë;
- b) monitoron zhvillimin e industrisë ushtarake në zbatim të politikave shtetërore në fushën e mbrojtjes e të sigurisë;

c) miraton lehtësirat për subjektet që synojnë të angazhohen dhe të investojnë në industrinë ushtarake;
ç) miraton operacionet e veçanta për t'u realizuar nga shoqëria shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake;

d) miraton, në rastet kur bashkëpunimi lidhet me interesat e shtetit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të shoqërisë shtetërore për prodhimin dhe tregtimin e armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake me subjektet private;

dh) miraton në rastet e përcaktuara nga ky ligj detyrimin e shoqërisë shtetërore për të siguruar një rezervë të caktuar armatimesh dhe pajisjesh teknologjike për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

e) përgjegjësi të tjera të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

7. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes kryen rolin e sekretariatit të Komitetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

KREU IX DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 37

Bashkëpunimi në kuadër të legjislacionit ekzistues

Të gjitha organet shtetërore të përfshira në kontrollin e transportit, eksportit dhe importit të armatimit ushtarak dhe të artikujve të teknologjive me përdorim të dyfishtë bashkëpunojnë ngushtë me Agjencinë, me qëllim raportimin, monitorimin e shpërndarjes dhe të përdorimit të ligjshëm të armatimit ushtarak, në kuadër të harmonizimit ligjor, si dhe në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi.

Neni 38

Dispozitë kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, deri në miratimin e akteve të autorizuar vijojnë të zbatohen dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi për rregullimin e prodhimit, tregtimin, kërkimin dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake.

2. Lejet, licencat dhe autorizimet ekzistuese në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji i nënshtrohen procesit të vlerësimit dhe të konfirmimit nga Agjencia, në përputhje me parashikimet e këtij ligji, brenda 2 vjetëve nga ngritja e saj. Subjektet gjatë kësaj periudhe plotësojnë detyrimet në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

3. Organe të tjera, të cilat janë duke shqyrtuar aplikime për licenca të trajtuara nga ky ligj dhe për të cilat nuk ka një vendim përfundimtar, do t'i përcjellin për kompetencë pranë Agjencisë.

Neni 39

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 6 të nenit 10; të pikës 5 të nenit 12; të pikës 3 të nenit 14; të pikës 3 të nenit 16; të shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 26; të pikës 6 të nenit 27; të pikës 2 të nenit 31; të pikës 2 të nenit 34; të pikës 6 të nenit 36, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, si dhe në rastet e nevojshme të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 2 të nenit 9.

2. Ngarkohet Kryeministri të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të pikës 5 të nenit 10 brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 5 të nenit 18 dhe të pikës 2 të nenit 35 brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 40

Hyrja në fuqi

Ky ligj në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 26.7.2024.

Shpallur me dekretin nr. 287, datë 5.8.2024, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.